



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Data/nr	19.10.2023 <u>01-463/02-20704</u>
Për:	Arbëneshë Kuqi, Kryesuese e Kuvendit të Komunës së Gjakovës
CC:	- Të gjithë anëtarëve të Kuvendit të Komunës së Gjakovës - Arkivit
Nga:	Ardian Gjini, Kryetar i Komunës së Gjakovës
Lënda:	Propozim Vendim për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Kishës Katolike Pjetershan



Të nderuar,

Duke u bazuar në nenin 58 shkronja (h) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 24 dhe 25 të Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, dispozitave të Statutit të Komunës së Gjakovës të miratuar me datë 28.12.2022, Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 19.10.2023 e parashtron në Kuvendin e Komunës së Gjakovës këtë:

P R O P O Z I M V E N D I M

1. Kuvendi i Komunës së Gjakovës të miratojë vendimin për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën në pronësi të Kishës Katolike Pjetershan.
2. Prona e paluajtshme komunale që do të jepet në këmbim, ka këto karakteristika si vijon:
 - 2.1 Pjesë e parcelës kadastrale nr. P – 70705057-01300-0, Zona kadastrale Pjetershan, e evidentuar në pronësi të Komunës së Gjakovës, sipas planit “Zhvillimor Komunal 2022-2030”, në këtë pjesë të parcelës është përcaktuar me destinim si Zonë e Shërbimeve/Shërbim Fetar/Kishë Katolike.
 - 2.2 Ndërsa prona e paluajtshme që merret nga ky këmbim, është pjesë e parcelës kadastrale P-70705057-01301 - 2, Zona kadastrale Pjetershan, në pronësi të Kishës Katolike, sipas planit “Zhvillimor Komunal 2022-2030”, në këtë pjesë të parcelës është përcaktuar me destinim si Zonë e Komunikacionit dhe Transportit/Rrugë.

3. Qëllimi i këmbimit të pronës së paluajtshme është realizimi i planit Zhvillimor Komunal 2022-2030”, si dhe për shkak të gjendjes faktike në këto parcela.
4. Pas hyrjes në fuqi të këtij vendimi, organet e administratës së Komunës së Gjakovës do t’i ndjekin procedurat në organet kompetente që të paraqesin kërkesën për vlerësimin e pronave të paluajtshme si në pikën dy (2) të këtij propozim vendimi, për pjesën e sipërfaqes që do të këmbehet sipas planit të lartshënuar.
5. Mënyra dhe kushtet e këmbimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe pronarit të parcelës kadastrale që do të këmbehet.
6. Për zbatimin e vendimit kujdeset Kryetari i Komunës dhe administrata e Komunës së Gjakovës.
7. Pjesë përbërëse e këtij Propozim vendimi janë:
 - Certifikata mbi pronësinë
 - Kopjet e planit
 - Materialet përcjellëse

Me respekt!